



Ushtrim:

Përdorimi i standarteve ISACS-AT në kontekst të kryerjes së vezhgimeve për AVL

ISACS moduli Operativ 05.10: kryerja e vezhgimeve për armët e vogla dhe të lehta

SKENARI – Konteksti

Vendi O ka dale para pak kohe nga periudha e konfliktit dhe dhunës së armatosur, që ka zgjatur disa vite dhe ka shkaktuar përhapje të madhe të armëve tek aktoret jo-shtetërore të cilët i kanë marrë keto arme qoftë nëpërmjet donacioneve direkte të qeverive të huaja, ose kanë “rrjedhur” nga rezervat shtetërore, ose janë gjetur në luftë, ose janë marrë nëpërmjet tregtisë nderkufitare për shkak të kontrollit të dobët kufitar.

Këshilli i sigurimit i OKB, ku ka patur mendime të ndryshme për çështjen e konfliktit në shtetin O, nuk ka caktuar embargo për armë ndaj këtij vendi, por disa shtete në rajon kanë vendosur sanksione qëllimore pas fillimit të konfliktit. Shtetet që kanë vënë sanksione kanë treguar qëndrim të qartë se, nëse do heqjen e sanksioneve shteti O duhet të bëjë, përparojë e demonstrojë masat e kontrollimit të armëve.

Para fillimit të konfliktit, ky shtet ka qënë prodhues i armëve dhe importues/eksportues i armëve të vogla e të lehta. Organet e sigurisë kanë qënë së pari agjensi shtetërore, si për shembull policia, por kanë egzistuar dhe kanë vepruar aktivisht një sërë kompani sigurie në vend, para së gjithash në kryeqytet por dhe në pjesët e tjera të qytetit. Edhe pse me fillimin e luftës numri i kompanive të sigurisë në shtetin O u pakësua, me përfundimin e konfliktit është vënë re një rritje në përdorimin e shërbimeve të këtyre kompanive.

Pas përfundimit të konfliktit, tetë muaj më parë, vlerësimet fillestare për sasinë e armëve tregojnë ndërmjet 1,9 e 2,1 milionë copë të armëve të vogla dhe të lehta në shtetin O, dhe prej këtyre më shumë se dy të tretat qarkullojnë jashtë rezervave në pronë të shtetit (këto vlerësime i kanë bërë organizata të jashtme për vezhgime duke u mbështetur në informatat nga burime të caktuara). Qeveria këto vlerësime nuk i konsideron si burim të sigurtë të të dhënave. Nuk ka mjaft informata për llojin e përdoruesve të këtyre armëve edhe pse ka disa grupe të armatosura për të cilat dihet se kanë armë të vogla dhe të lehta.

Pas përfundimit të konfliktit, me qëllim sigurimin e territorit dhe forcimin e aparatit të sigurimit për mbrojtjen e popullsisë, qeveria e re e shtetit O ka shprehur interesimin që të prodhojë përsëri dhe të importojë/eksportojë armë dhe municion. Më tej, qeveria momentalisht është e interesuar të shqyrtojë ndryshimet e ligjit për pronësinë civile të armëve të vogla dhe të lehta, dhe ka shprehur interesimin që të zbatojë programin e mbledhjes vullnetare të armëve.

Siç është përshkruajtur më lart, Qeveria si një prej prioriteve të veta ka vendosur edhe kontrollin e SALW. Si hap i parë i ka kërkuar Komisionit Kombëtar për SALW të planifikojë një vezhgim për SALW, për të pasur një pasqyrë të qartë për shpërndarjen e këtyre armëve dhe të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve politike dhe projekteve të aktiviteteve të përbashkëta, që do të zbatohen së bashku me partnerët ndërkombëtarë dhe kombëtarë. Vezhgimi i fundit për kontrollin e armëve të vogla është bërë para 6 vjetësh në periudhën para fillimit të konfliktit.

* * * * *



DETYRË për të dyja ekipet

Ju jeni pjesë e ekipit të pavaruar, të jashtëm të konsulentëve që i ka angazhuar Komisioni Kombëtar për SALW me qëllim realizimin e një vëzhgimi për armët e vogla dhe të lehta. Si hap i parë në vëzhgim, Komisioni ka kërkuar që të kaloni nëpër metodologjinë e mbledhjes të të dhënave, të vëzhgimit të mëparshëm para fillimit të konfliktit, që të jepni vlerësimin profesional të mënyrës së pasqyrit dhe të përgatitni raportin me komentet tuaja për komisionin.

Komisioni para së gjithash është i interesuar që të përdorë ISACS modulën 5.10, Kryerja e vëzhgimeve për armët e vogla, klauzola 9.6.2, si bazë për mbledhjen e informacionit si vijon:

- 1) Cilat të dhëna kanë mbuluar mirë vëzhguesit e mëparshëm; e
- 2) Cilat të dhëna i kanë lënë.

Për të dhënat që mungojnë /që nuk i kanë përfshirë vëzhguesit e mëparshëm, duhet:

- a) të shpjegoni rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të tilla; dhe
- b) të propozoni se si mund t'i mbledhë Komisioni këto të dhëna duke përdorur vëzhgimet.

Sipas udhëzimeve të Komisionit, në kryerjen e kësaj detyre duhet të konsultoni standardet ISACS. Kryesorja e detyrës tuaj është që të bindni Komisionin që të kryejë një vëzhgim të përgjithshëm. Rezultatet tuaja do t'ia dorëzoni kryetarit të Komisionit. Mund të shpreheni ose me gojë, ose me ndihmën e materialit vizual. Mund të përdorni versionin e printuar të standardit të ISACS ose ISACS-AT.

SUPOZIM

Punoni me informatat që keni. Të gjitha informatat në dispozicion për të dhënat e mbledhura në vëzhgimin e mëparshëm, janë dhënë në vazhdim. Nëse mungon ndonjë informatë, kjo do të thotë se informata në fjale nuk është vërtetuar, paraqitur, ose nuk ju është vënë në dispozicion.

NDIHME

Kujtoni hapat në kryerjen e vlerësimit:

1. Identifikoni informacionin që duhet të matet në Modul;
2. Me ndihmën e ISACS-AT PDF, mbledhni të dhënat e nevojshme;
3. Analizoni rezultatet me qëllim që të informoni mbi gjetjet dhe raportin.

* * * * *



Metodologjia e vlerësimit të shpërndarjes së të dhënave për armët e vogla dhe të lehta që i ka mbledhur agjensia (A) para fillimit të konfliktit.

Pasqyra e situatës

Të dhënat janë mbledhur prej agjensive shtetërore, si dhe prej ushtrisë, policisë, doganës dhe rojeve të kufirit. Emrat e këtyre agjensive janë shënuar (gjithsej 5), por nuk ka qënë e mundur të merren të dhëna për sasi të dhe llojet e armëve të vogla në pronësi të çdo agjensie shtetërore. Gjithashtu vëzhgimi ka mbledhur të dhëna për numrin e përgjithshëm të stafit nga çdo agjensi, por nuk ka patur mundësi të vërtetohet numri i të punësuarve në këto agjensi që kanë patur akses në armët e lehta.

Në vëzhgim janë mbledhur të dhënat për armët e vogla në pronësi civile. Janë mbledhur të dhënat për bazen ligjore me të cilën është rregulluar mbajtja e armëve të vogla dhe të lehta nga civilët, si dhe të dhënat për llojet dhe kategoritë e lejeve pronarë të të cilëve janë persona privatë dhe klube private të qitjes. Të dhënat e mbledhura për numrin e lejeve aktive, janë ndarë sipas llojit të lejes. Përsa i përket numrit të kërkesave leje, të dorëzohen çdo vit, janë mbledhur pak të dhëna dhe këto informata nuk janë shpërndarë sipas llojit të lejes. Informatat për skadencën e lejeve nuk janë mbledhur. Në vëzhgim janë mbledhur të dhëna për sasinë dhe llojet për armët e vogla dhe të lehta në pronësi ligjrisht nga civile. Të dhëna të sakta nuk janë marrë dot për armët e vogla në pronësi ilegale.

Informacioni për kompanitë private të sigurisë ishte i kufizuar dhe prandaj nuk janë marrë të dhëna domethënëse nga ato.

Prodhimi

Janë mbledhur të dhëna të përgjithshme për prodhimin e armëve të vogla, armëve të lehta, pjesëve përkatëse, komponenteve dhe municioneve. Janë mbledhur edhe disa të dhëna baze për kuadrin ligjor dhe rregullativ për prodhimin vendor duke përfshirë edhe llojet dhe kategoritë e lejeve dhe autorizimeve që janë të domosdoshme për prodhim. Ka patur gjithsej shtatë prodhues të autorizuar dhe kapacitetet prodhuese të tyre njihen. Gjithashtu janë marrë të dhëna për sasinë dhe llojin e armëve të vogla dhe municionet që prodhohen legalisht.

Vëzhgimi nuk ka përfshirë të dhënat për numrin e prodhuesve të paautorizuar dhe kapacitetet e tyre prodhuese, duke përfshirë edhe sasi të dhe llojet e armëve që prodhojnë ilegalisht. Nuk egziston shpjegim i qartë përse janë përfshirë këto të dhëna.

Shitja

Të dhënat për shitjen vendore dhe ndërkombëtare të armëve të vogla nuk ka patur mundësi që të mbledhen, as për ndërmjetësuesit e autorizuar në shitjen e armëve, për shkak të aksesit të kufizuar tek ky informacion. Theksojmë se Qeveria nuk ka qënë plotësisht transparente dhe nuk ka bashkëpunuar në shkëmbimin e informatave lidhur me rregullat ligjore që kanë të bëjnë me lejet dhe autorizimet për shitjen e armëve.

Informacionet për tjetërsime

Nuk ishte e mundur që të mbledheshin të dhëna për sasinë dhe llojet e armëve të vogla, armëve të lehta dhe municionet që kanë humbur ose ju janë vjedhur partnereve perkates, duke përfshirë armët që kanë humbur nga agjensitë shtetërore, kompanitë private të sigurisë dhe personat fizike. Vëzhguesit edhe këtu përmendin se Qeveria nuk ka qënë plotësisht transparente kur flitet për tjetërsimet.

Mbledhja dhe asgjësimi

Nuk ka të dhëna për armët e vogla, armët e lehta dhe municionet që kanë dorëzuar civilët ose që i ka marrë /konfiskuar shteti. Deri tani nuk është organizuar asnjë fushatë e mbledhjes së armëve në shtetin O. Megjithatë, informacione janë dhënë në lidhje me praktikën e shtetit për menyrat e asgjësimit të armëve të padëshiruara.

* * * * *

